

VENDIM
Nr. 139, datë 6.3.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 617, DATË 29.7.2020, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘RRUGA E ARBRIT’ (SHITESA)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 617, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rruga e Arbrit’ (shtesa)”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, togfjalëshi “... prej 16 808 960 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh” zëvendësohet me “... prej 16 834 460 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekësh”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 16 834 460 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) Vlera e shpronësimit, prej 16 808 960 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga fondet buxhetore për vitin 2020, të miratuara në zërin “Shpronësime”, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, në programin buxhetor “Transporti rrugor”.

b) Vlera, prej 25 500 (njëzet e pesë mijë e pesëqind) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit në fuqi i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën shtesë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

3. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Bulqizë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RRUGA E ARBRIT” (SHITESA)

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË						VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
								Shpronësim tokë “arë”			Shpronësim tokë “truall”				
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
41	Kujtim	Osman	Sinani	3444	5/83	ARË	1313	255.0	100.0	25 500				25 500	
SHUMA								255.0						25 500	